

“BACHELOR” NË INFERMIER - MAMI

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Universitare Bachelor në Infermier– Mami
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.38, datë 28.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i parë
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njehësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit Infermier – Mami është të aftësojë studentët në rolin e tyre si specialist në perdorimin e sistemeve të reja te teknologjise infermiore per shendetin e gruas ne nje nivel te larte profesional. Ata jane te afte te veprojne si Infermiere te profilit Mami, programues te politikave shendetesore per gruan dhe rregullues te mangesive neper maternitetet edhe administratoreve te te dhenave ne sistemet e mbledhjes se te dhenave nga kartelat e grave te shtruara neper maternitete apo qe ndiqen neper Konsultoret e Gruas. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të jenë të përgatitur për pozicionin Infermier-Mami në një game të gjere organizmash shendetesore
2. Të sigurojnë një themel të thellë në Infermierinë e aplikuar për profilin Mami së bashku me aspektet praktike të disipline
3. Të sigurojnë njohuri të programit Infermier-Mami me qëllim arritjen e objektivave organizative përmes përdorimit të resurseve efektive.
4. Të pajisë me aftësi themelore në teknologjinë infermiore për profilin Mami për të përgatitur që të përshkruajnë ndryshimeve teknologjike në fushat mjekësore që lidhen me shëndetin e gruas.
5. Të sigurojnë shërbime infermiore për profilin Mami që mund të takojnë nevojat e perceptuara ose të papercceptuara të individëve, organizmave dhe komuniteteve.
6. Të krijojnë, të ruajnë dhe të vlerësojnë ambientet infermiore të duhura për profilin përkatës
7. Programi i studimit synon të formojë profesioniste të zhvilluar, që operojnë, shfrytëzojnë dhe menaxhojnë brenda në grup, si edhe të nxirren aftësi ndërpersonale dhe komunikuese të tyre si një profesionist i fushës infermiore në profilin Mami.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e Infermier-Mamisë.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi profesionale që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojnë një performancë sa më të lartë në mjedisin spitalor ose ambulator në të cilin do të veprojnë si të punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të teknikave infermiore për mamitë, bazat e infermierisë, infermieristikë në gjinekologji, obstetrikë, riprodhim etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit BAZE**(Sociologji, Shkenca biomedikale 1, Anatomi e njeriut, Fiziologji e njeriut, Anatomi patologjike, Fizpatologji riprodhuese) **Kredite (31 kredite)**
2. **Lëndë të formimit KARAKTERIZUESE** (Bazat e infermieristikes, Shkenca Biomedikale 2, Puerikulture & Neonatologji, Shtatzani dhe lindja normale, Infermieristika ne shtatzani dhe lindje normale, Pediatri, Lende kirurgjikale dhe urgjenca mjekesore, Farmakologji, Shkenca infermierore, Risqet& komplikacionet e shtatzanise, Infermieristika e komplikacioneve obstetrikale, Virologjia&Diagnoza laboratorike ne virologji, Gjinekologji & Shendet riprodhues, Infermieristike ne Gjinekologji &Shendet riprodhues) **Kredite (91.5 kredite)**
3. **LëndëNDERDISIPLINORE/INTEGRUESE** (Biokimi mjekesore & Biofizike mjekesore, Shkencat e shendetit, Patologjite e Pergjithshme, Lende me zgjedhje) **Kredite (19 kredite)**
4. **LëndëME ZGJEDHJE** (Dietologji, Faza preanalitike, Psikologji mjekësore, Shkrim & menaxhim projektsh, Fizioterapi, Radiologji) **Kredite (6 kredite)**
5. **LëndëPLOTESUESE** (Informatike & Statistike mjekesore, Gjuhë e huaj profesionale, Praktike infermierore 1, Praktike infermierore 2) **Kredite (27 kredite)**
6. **Detyrime PERMBYLLESE** (Punim diplome)**Kredite (5.5 kredite)**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në Infermier - Mami është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë për Infermier-Mami është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e thellimit të studimeve në Ciklet e Dytë të Nivelit Master (Profesional apo Shkencor).

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor* në Infermier - Mami mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në Master Profesional në Shkencat Infermierore, apo në një fushë të ngjajshme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programet Master Profesional apo Shkencor (pranë Universitetit të tyre ose në Universitetet e tjera).

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli të studimit, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë Infermier - Mami në fushën e infermierisë dhe mamië të kualifikuar me njohuritë mesiperme. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në Infermier – Mami është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Maternitete
2. Konsultoret e gruas
3. Drejtorite shëndetësore në rrethë
4. Poliklinika për shëndetin e gruas
5. Qendra shëndetësore rajonale e lokale

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	SOCIOLOGJI	4.5	112.5	I
2.	SHKENCA BIOMEDIKALE 1	7	175	I
3.	SHKENCA BIOMEDIKALE 2	5	125	I
4.	INFORMATIKE & STATISTIKE MJEKESORE	3	75	I
5.	GJUHE E HUAJ PROFESIONALE	4	100	I
6.	SHKENCA TE SHENDETIT	5	125	I
7.	ANATOMI E NJERIUT	6	150	I+II
8.	BAZAT E INFERMIERISTIKES	11	275	I+II
9.	FIZIOLOGJI E NJERIUT	4.5	112.5	II
10.	BIOKIMI MJEKESORE & BIOFIZIKE MJEKESORE	5	125	II
11.	PUERIKULTURE & NEONATOLOGJI	5	125	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	I+II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	ANATOMI PATOLOGJIKE	5	125	I
2.	SHTATZANIA DHE LINDJA NORMALE	6	150	I
3.	INFERMIERISTIKE NE SHTATZANI & LINDJE NORMALE	8	200	I
4.	PEDIATRI	5	125	I
5.	PRAKTIKE INFERMIERORE 1	10	250	I+II
6.	FIZPATOLOGJI RIPRODHUESE	4	100	II
7.	FARMAKOLOGJI	5	125	II
8.	LENDE KIRURGJIKALE & URGJENCA MJEKESORE	4.5	112.5	II
9.	SHKENCA INFERMIERORE	9.5	237.5	II
Lëndë me zgjedhje				
10.	A DIETOLOGJI	3	75	II
	B FAZA PREANALITIKE	3	75	II
	C. PSIKOLOGJI MJEKESORE	3	75	II
	D. SHKRIM & MENAXHIM PROJEKTESH	3	75	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	I+II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	RISQET DHE KOMPLIKACIONET E SHTATZANISE	9	225	I
2.	INFERMIERISTIKE E KOMPLIKACIONEVE OBSTETRIKALE	4	100	I
3.	VIROLOGJIA & DIAGNOZA LABORATORIKE NE VIROLOGJI	6	150	I
4.	PRAKTIKE INFERMIERORE 2	10	250	I+II
5.	PATOLOGJI E PERGJITHSHME	9	225	II
6.	GJINEKOLOGJI & SHENDET RIPODHUES	4.5	112.5	II
7.	INFERMIERISTIKE NE GJINEKOLOGJI & SHENDET RIPODHUES	9	225	II
Lëndë me zgjedhje				
8.	A FIZIOTERAPI	3	75	I
	B RADIOLOGJI	3	75	I
9.	Provim formimi / Punim diplome	5.5	137.5	II
Gjithësej viti i tretë		60 ECTS	1500	I+II
Total : viti I + viti II + viti III		180 ECTS	4500	